

VENDIM
Nr.65, datë 22.9.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA NGA ERE
SHOQËRISË HERA SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë HERA sh.p.k.,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt, përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 12 muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën “1” dhe “4” të vendimit nr.61, datë 2.11.2007 “Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale HERA sh.p.k. (Projekti KAPPET)”, të ndryshuar me vendimin nr.93, datë 6.08.2008 “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.61, datë 2.11.2007 “Për dhënien e licencës për ndërtimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta